

VENDIM
Nr.3, datë 2.2.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““
Veli Budo,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Franc Jakova,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Halil Kopani,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““

me sekretare Drita Filto, më datë 21.01.1998 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.5 Akti, që i përket :

KËRKUESE : SHOQERIA E KRYETARËVE TË BASHKIVE, e përfaqësuar nga ZZ.Buron Kaceli, Ardian Haçi dhe Osman Hoxha, me autorizim.

SUBJEKT I INTERESUAR:

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, në mungesë.

OBJEKTI:

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.161, datë 11.03.1996 “Për organizimin e strukturave të gjendjes civile”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi shpjegimet e palës kërkuese dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.161, datë 11.3.1996 “Për organizimin e strukturave të gjendjes civile”, në pikat 1,4 e 5 vjen në kundërshtim me ligjin nr.7608, datë 22.2.1992 “Për prefekturat” me ndryshimet që i janë bërë me ligjin nr.8209, datë 22.4.1997, pasi në asnjë nen të këtyre ligjeve mbi të cilat bazohet vendimi i Këshillit të Ministrave nuk parashikohet që prefekti ka kompetenca të emërojë dhe shkarkojë nëpunësat e gjendjes civile. Përkundrazi, në nenin 5 të ligjit nr.8209, datë 22.4.1997 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7608, datë 22.2.1992 “Për prefekturat”, përcaktohet se prefekti ka të drejtën e emërimit dhe të shkarkimit vetëm për personelin e administratës së prefekturës, dhe të drejtën e propozimit për emërimin dhe shkarkimin e sekretarëve të këshillave lokale dhe drejtuesve të shërbimeve të administratës shtetërore në nivel lokal.

Është e vërtetë se në ligjin “Për prefekturat” është parashikuar se prefekti ushtron edhe kompetenca të tjera që i delegohen nga Këshilli i Ministrave, por atij mund t’i delegohen vetëm ato kompetenca që nuk vijnë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Në këto kushte, gjykata arrin në përfundimin se pikat 1,4 e 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.161, datë 11.3.1996 “Për organizimin e strukturave të gjendjes civile”, duhet të shfuqizohen.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 e vijues të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

VENDOSI:

Shfuqizimin e pikave 1.4 e 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.161, datë 11.3.1996.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.